

**OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË**

Nr. 3529 prot.
Tiranë, më 21.06.2024

Nr. 229 prot.
Tiranë, më 24.06.2024

Lënda: Kërkesë për marrjen në shqyrtim të ndryshimit të afatit të nominimit në tregun e balancimit

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Bulevardi "Bajram Curri", Rruga "Viktor Eftimiu" nr.1023, Tiranë.

I nderuar Z. Ahmeti,

Në zbatim të vendimit të ERE nr.40 datë 06.03.2020 mbi "Miratimin e Rregullores së Kërkesave dhe Procedurave për Përcaktimin e Operatorit të Emëruar të Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO) si dhe rolet e përgjegjësitë e NEMO dhe operatorëve të sistemit të transmetimit të energjisë në tregun e bashkuar", lidhur me detyrimet që i lindin NEMO (ALPEX sh.a) dhe OST mbi implementimin e bashkimit të tregut të energjisë elektrike të ditës në avancë dhe brenda së njëjtës ditë, Ju informojmë se aktualisht ALPEX në bashkëpunim me OST dhe KOSTT po punojnë mbi implementimin e procesit të Tregut të Ankandave Brenda së Njëjtës Ditë dhe bashkimit të këtij tregu. Krahas rregullores së lartpërmendur, ky proces do të kryhet në përputhje me parashikimet e "Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike" miratuar me vendimin e ERE nr. Nr. 347, Datë 27.12.2022 dhe praktikat më të mira të vendeve të BE, përfshirë edhe kornizat kohore.

Përsa më sipër, del e nevojshme rishikimi i "Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit" lidhur me afatin e përditësimit të nominimeve në platformën e menaxhimit të tregut në OST, konform afateve kohore të ankandave brenda së njëjtës ditë.

Në vendimin e ERE nr. 106 datë 02.07.2020, mbi miratimin e "Rregullave Të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike" lidhur me afatet e procesit të nominimit citohet se "Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 45 minuta para fillimit të 15 minutave të para të përfshira në përditësim."

Ky afat ndikon në proceset për përditësimet e nominimeve mbi transaksionet brenda se njëjtës ditë. Gjithashtu, nga eksperiencia gjatë zhvillimit të fazës Dry Run për Tregun Balancues u identifikua si nga OST ashtu edhe nga palët e tregut se afati për përditësimin e nominimeve ishte relativisht i gjatë. Kjo problematikë është hasur edhe gjatë operimit live të tregut balancues.

Në propozimet e përcjella nga OST, bazuar në eksperiencën e fituar si dhe nga sugjerimet e palëve të tregut, për përmirësimet e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit

është propozuar ndryshimi “Nominimet mund të përditësohen brenda ditës, së paku 15 minuta para fillimit të periudhës së lëvrimit”. Një ndryshim i tillë do të rrisë fleksibilitetin e tregut balancues duke u përshtatur me ndryshimet që mund të ndodhin në kohë reale. Përmendim këtu parashikimin dhe përditësimin pranë kohës reale për ofruesit e shërbimeve të balancimit, për prodhuesit fotovoltaiik dhe run-of-river të cilët do të kenë mundësi të përditësojnë pothuajse në kohë reale çdo ndryshim të paparashikuar, duke reduktuar disbalancat në sistem dhe njëkohësisht duke ndikuar në ruajtjen e balancës totale të sistemit.


Gjithashtu, ashtu sikurse kemi cituar më lartë, ndryshimi i afatit të nominimeve është një domosdoshmëri për Bashkimin e Tregjeve Brenda të Njëjtës Ditë, pasi është një faktor pengues në zhvillimin e mëtejshëm të këtij procesi.

Si përfundim për sa më sipër, OST dhe ALPEX propozon marrjen në shqyrtim nga ana juaj të kërkesës së përbashkët për ndryshimin e afatit mbi përditësimet e nominimeve të transaksioneve tregtare.

Duke shpresuar që propozimi ynë do merret në konsideratë nga ana juaj, mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST SH.A.


Skerdi Drenova
ADMINISTRATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT

ADMINISTRATORI I ALPEX SH.A.

Sokol Dishnica

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
ALPEX
Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike
NUIS M022230068